



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Datë ____/____/ 2018

V E N D I M

Nr. 92 , Datë 05 / 04 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.14 Regj, datë 22.01.2018, të znj.D. D, përfaqësuar nga organizata “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, Elbasan”, me pretendimin për diskriminim për shkak të “etnisë¹” dhe “të gjendjes ekonomike²”, kundër: Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, Entit Rregullator të Energjisë, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve.

Subjekti ankues, znj.D. D ka informuar Komisionerin lidhur me problematikën e saj, e cila konsiston në faktin se, prej dy vitesh i është ndërprerë furnizimi me energji elektrike nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Elbasan, gjë që jo vetëm ka përkeqësuar kushtet e jetesës por edhe gjendjen shëndetësore të saj. Ankuesja është e moshuar dhe jeton e vetme. Burimi i vetëm i të ardhurave për të është pagesa e përfituar nga skema e ndihmës ekonomike, në masën 7.064 lekësh të rinj (zonja përfiton pension social). Duke u ndodhur në vështirësi ekonomike, znj.D e ka të pamundur përballimin e pagesës së faturës së energjisë elektrike.

¹ Ankuesja është anëtare e komunitetit egjiptian.

² Ankuesja trajtohet me ndihmë ekonomike.

Ligji nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikon gëzimin e disa të drejtave të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruara në raste përjashtimore, si pasojë e gjendjes sociale. Neni 108 i këtij ligji ngarkon Këshillin e Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e tij, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve siç specifikohen në të.

Kështu, në zbatim të këtij neni, Këshilli i Ministrave duhet që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të kishte nxjerrë aktet nënligjore për kriteret dhe procedurën për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre.

Subjekti ankues pretendon se mos nxjerrja e këtyre akteve e ka vënë atë në pozita diskriminuuese, pasi mund të ishte përfituese e statusit të klientit në nevojë dhe në këtë rast nuk do t’i ndërpritej furnizimi me energji elektrike, gjë që nuk do të ndikonte negativisht në mënyrën e jetesës dhe në gjendjen e saj shëndetësore.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimoreose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.126/1 prot, date 31.01.2018 ju kërkua informacion: Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, Entit Rregullator të Energjisë, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a. lidhur me pretendimin e ngritur nga subjekti ankues, znj.D. D.

- Me shkresën me nr.2308/1 prot., datë 08.02.2018, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, informon Komisionerin, se: *“...duke marrë në konsideratë fushën e përgjegjësisë shtetërore që mbulon, përcaktuar në VKM nr.503, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” ka tagrin për të propozuar projekt-akte, objekti i të cilave përfshihet në fushën e përgjegjësisë së saj. Në këtë kuadër, hartimi dhe zbatimi i politikave për kategorinë e shtresave në nevojë, është kompetencë e ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, e cila ndërmerr nismat propozuese për këtë kategori personash. Për sa më lart, shprehim gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe për të dhënë kontributin tonë, në momentin që iniciativa nënligjore do të propozohet, me qëllim ezaurimin e kërkesave të dispozitës deleguese”.*
- Me shkresën me nr.965/2 prot., datë 13.02.2018. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka informuar Komisionerin se: *“...Të gjitha familjet që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, përfitojnë disa lehtësira përsa i përket detyrimeve ndaj OSHE-së. Në raste të tilla midis subjekteve debitore dhe OSHE-së lidhet një marrëveshje e cila lehtëson procesin e shlyerjes së detyrimit me këste, për familjet në nevojë që përfitojnë ndihmë ekonomike. Po ashtu, kjo kategori familjesh përfiton kompensim financiar për energjinë ekeletrike në masën 1288 lekë të rinj, në muaj”.*
- Me shkresën me nr.153/1 prot., datë 16.02.2018, Enti Rregullator i Energjisë, ka informuar Komisionerin se: *“...Subjekti ankues është përfitues i ndihmës ekonomike dhe kategorizohet në një kategori të caktuar klientësh të energjisë elektrike, të cilësuar si “klientë në nevojë”. Ligji nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” e ka rregulluar këtë marrëdhënie ndërmjet dispozitave të përcaktuara në nenet 95 e 96 të tij. Lidhur me detyrimin që buron nga këto dispozita, ERE, në vendimin e Bordit me nr.213, datë 28.12.2017, miratoi fillimin e procedurave për shqyrtimin e draft rregullores “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për klientët në nevojë”³. Gjithashtu ERE me shkresën me nr.19 prot., datë 04.01.2018 para se të vijojë me miratimin e kësaj rregulloreje, ka ftuar të gjitha palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre, me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja dijeni, me qëllim përmirësimin e këtij dokumenti”. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka marrë dijeni për hartimin e draft rregullores së ERE-s, në kuadër të shqyrtimit të ankesës,*

³ Draft-rregullorja është e publikuar në faqen e internetit të ERE-s : www.ere.gov.al në seksionin: “Konsultime”.

nëpërmjet shkresës nr.153, datë 16.02.2018 të ERE-s, të marrë në dorëzim nga Komisioneri me nr.126/4, datë 20.02.2018, pra një ditë pas mbarimit të afatit të caktuar nga ERE.

- Me shkresën me nr.2717/1 prot., datë 28.02.2018, Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë, informon Komisionerin, se: “...Referuar nenit 95 të ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe VKM-së nr.504, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, MIE në cilësinë e ministrisë përgjegjëse për Energjinë, shpreh gatishmërinë maksimale për të bashkëpunuar në dhënien e kontributit të nevojshëm për hartimin e kriterëve dhe procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre”.

Ligji nr.43, datë 30.04.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, është botuar në Fletoren Zyrtare nr.87, datë 28.05.2015 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare. Aktet nënligjore objekt i shqyrtimit të kësaj ankese duhet të ishin miratuar nga Këshilli i Ministrave, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, pra brenda datës 15.06.2016.

III. Vlerësimi i Komisionerit, i fakteve dhe provave të grumbulluara, gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Përsa më sipër, Komisioneri analizoi situatën e krijuar, duke iu referuar jo vetëm ankesës individuale të znj.D, por duke e shtrirë problematikën për të gjithë kategorinë e personave që përfitojnë statusin e “klientit në nevojë”. Kjo për shkak se mungesa e akteve nënligjore për kriteret dhe procedurën për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, prek drejtëpërdrejtë jo vetëm ankuesen si individ, por të gjithë kategorinë sipërcituar.

Konkretisht, referuar Vërtetimit me nr.1154 prot., datë 09.03.2018 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Elbasan, subjekti ankues, znj.D. D, me nr.pension 534 përfiton pension social në masën 7.064 lekë të rinj. Ajo është e moshuar⁴, (87 vjeçe) dhe jeton e vetme. Sikundër shihet qartë, znj.D klasifikohet në ato shtresa vulnerabël, jo vetëm në pamundësi ekonomike por edhe në pamundësi sociale, për të siguruar përmbushjen e nevojave më minimale të një jetese normale.

⁴ Referuar Kartës së Identitetit, datëlindja e znj.D. D rezulton me 18.11.1931.

Legjislacioni i Ndhmës Ekonomike dhe Përkujdesit Social mbron familjen në përgjithsi dhe individin në veçanti nga pikëpamja ekonomike, duke i siguruar një ndihmë ekonomike mujore, nëse ndodhet në kushtet e mungesës së plotë të të ardhurave ose i ka ato të pamjaftueshme.

Znj.D është përfituese bazuar në këtë legjislacion, por sërisht të ardhurat e vetme të saj, të cilat janë si rezultat ndihmës ekonomike, nuk mundësojnë përmbushjen e nevojave më minimale për një jetesë normale. Në këto kushte, ajo e ka të pamundur përballimin e pagesës së faturës së energjisë elektrike. Kështu, ndërprerja e furnizimit me energji elektrike të ankueses prej dy vitesh, përveçse cënon jetesën normale dhe dinjitetin e saj, ka vendosur në pozita risku dhe gjendjen e saj shëndetësore, nisur nga mosha e saj 87 vjeçare. Aksesit në burimet thelbësore të jetesës është një nevojë humane thelbësore dhe për rrjedhojë një e drejtë elementare për t'u respektuar. Mungesa e aksesit të plotë në këto burime është një rrezik i madh dhe goditje e rëndë për dinjitetin njerëzor.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Kështu, Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”.* Neni 18, i saj shpreh se *“1.Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”.*

Neni 52 i Kushtetutës në pikën 2, të tij⁵ parashikon se: *“Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarur nga vullneti i tij dher kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës ekonomike në kushtet e parashikuara në ligj”.* Kjo është një shprehje e mbrojtjes sociale, e realizuar përmes përmbushjes së objektivave social, dhe si e tillë realizimi i tyre është i lidhur

⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kreu IV, Liritë dhe të Drejtat Ekonomike , Sociale dhe Kulturore.

ngushtësisht me detyrimin e shtetit për të mundësuar garantimin dhe sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore.

Po sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore⁶ është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj dhe në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Neni 14, i KEDNJ, “Ndalimi i diskriminimit”, përcakton se : *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.

Direktiva 2009/72/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Evropës lidhur me rregullat e përbashkëta për tregjet e brendshme të energjisë elektrike, në nenin 7 të saj, citon se: *“ Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa adekuate për të mbrojtur konsumatorët dhe do të sigurojnë marrjen e masave adekuate mbrojtëse për të mbrojtur konsumatorët e cënueshëm. Në këtë kontekst, çdo shtet anëtar do të definojë konceptin e konsumatorëve të cënueshëm, i cili do t'i referohet varfërisë dhe midis të tjerave duhet të ndalojë ndërprerjen e energjisë elektrike për konsumatorët në raste kritike”*. Neni 8, i po kësaj Konvete parashikon se: *“Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa adekuate sikundër janë formulimi i planeve kombëtare të veprimit për energjinë, që sjell përfitime në sistemin e sigurimit social dhe për të siguruar furnizimin e nevojshëm të energjisë për konsumatorët e cënueshëm apo ofrimin e përkrahjes për përmirësimin e efikasitetit të energjisë...”*.

Ligji nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” e ka rregulluar këtë marrëdhënie ndërmjet dispozitave të përcaktuara në nenet përkatëse 95 e 96 të tij. Kështu, neni 95, përcakton se: *“Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë, Ministrinë e Financave, dhe në konsultim me ERE-n e grupet e interesit, harton*

⁶ Në vijim do ti referohemi me shkurtesën KEDNJ. Ajo është ratifikuar nga RSH me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996.

kriteret, procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret për përfitimin e statusit të klientit në nevojë marrin në konsideratë: a) klientët me të ardhura të ulëta, të cilët përdorin energjinë elektrike për furnizimin e vendbanimit të tyre të përhershëm. Klientët në nevojë, që përfitojnë mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit, regjistrohen në një regjistër të veçantë nga struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për mirëqenien sociale. Ky informacion i dërgohet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesit të energjisë elektrike. Klientët në nevojë, që përfitojnë mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit, duhet të përdorin fondet e përfituara për të paguar detyrimet e energjisë elektrike. Financimi për mbështetje të klientëve në nevojë duhet të bëhet në mënyrë jodiskriminuese, duke mos lejuar ndërfinancimin nga kategoritë e tjera të klientëve të energjisë elektrike. Mbi bazën e të dhënave të përcjella, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesi krijojnë dhe ruajnë një regjistër të të dhënave të klientëve në nevojë. Të dhënat e regjistrimit mund t'i vihen në dispozicion klientit në nevojë, në çdo kohë që kërkohen nga ky i fundit”.

Neni 96 , po këtu parashikon se: *“Klientët familjarë, të cilët kanë përfituar statusin e klientëve në nevojë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 95, të këtij ligji, kanë të drejtën e përfitimit të shërbimit të furnizimit universal, sipas parashikimeve të këtij ligji. Kontrata e furnizimit të klientëve në nevojë fillon në ditën që klienti regjistrohet prej Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si klient në nevojë”.*

Në analizë të sa më sipër, subjekti ankues kategorizohet në kategorinë e caktuar të klientëve të energjisë elektrike të cilësuar si “klientë në nevojë”.

Komisioneri vlerëson si masë pozitive hartimin e draft rregullores nga ana e ERE-s “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”, të cilën e gjen plotësisht të bazuar në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar, si dhe në përputhje të plotë me parashikimet e LMD-së⁷.

⁷ Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga dsikriminimi”.

Kështu, në nenin 5 të kësaj draft rregulloreje janë vendosur detyrimet e shërbimit publik, si masë mbrojtëse për interesat e klientëve në nevojë⁸:

“Furnizuesi duhet të vendosi sisteme/procese që sigurojnë që klientët në nevojë, të regjistruar si të tillë, të mos u ndërpritet furnizimi me energji elektrike gjatë periudhave të caktuara gjatë të cilave gëzojnë statusin e klientit në nevojë.

...Klientët e regjistruar, sipas kritereve specifike, si të varur në mënyrë kritike nga energjia elektike për jetën e tyre, nuk mund t’u ndërpritet furnizimi me energji elektrike për shkak të mospagesës së faturave të energjisë elektrike.

...Furnizimi me energji elektike nuk mund të ndërpritet edhe në rastet kur klienti, ka paraqitur dhe është në proces të trajtimit të kërkesës së tij, për t’u klasifikuar si “klient në nevojë”.

Mirëpo, pika 1, e nenit 95 të ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektike” ka përcaktuar qartazi se **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është struktura përkatëse për hartimin e kritereve, procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat më pas miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave; e cila, megjithë detyrimin ligjor nuk e ka përmbushur një detyrë të tillë.**

Komisioneri thekson se, mungesa e marrjes së masave për nxjerrjen e akteve nënligjore për hartimin e kritereve, procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrës së trajtimit të tyre, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, çënon rëndë jo vetëm përmbushjen e nevojave më minimale të një jetese normale të kësaj kategorie përfituesish, por edhe dinjitetin e tyre.

Dinjiteti i njeriut është një vlerë themelore kushtetuese⁹. Një shoqëri demokratike bazohet në dinjitetin e njeriut dhe parimin e barazisë së gëzimit të të drejtave themelore nga të gjithë individët.

⁸ Pika 2, e nenit 3 të kësaj draft rregulloreje ka përcaktuar “Klient në nevojë” atë klient familjar, i cili për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruara në raste përjashtimore, sipas përcaktimeve ligjore.

⁹Në Preambulën e Kushtetutës deklarohet: “Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”.

Kjo është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së¹⁰. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi apo një grupi personash, mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 3/1, parashikon se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

Neni 11, i LMD-së ka parashikuar dhe mundësinë e ndërmarrjes së një sërë masash pozitive, duke sanksionuar se: *“Masa e përkohshme, e veçantë që synon përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1, të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta”*.

Në këtë kuadër, Komisioneri, konstaton se znj.D. D, si dhe e gjithë kategoria e personave të cilët sipas përcaktimeve të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, mund të rezultojnë përfitues të statusit të “klientit në nevojë”, janë vënë në pozita jo të favorshme në përputhje me parashikimet e vetë këtij ligji; duke iu mohuar atyre mundësinë për të përfituar nga furnizimi me energji elektrike në periudha të caktuara gjatë të cilave gëzojnë statusin e

¹⁰Referuar nenit 3, pika 8 ,e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

klientit në nevojë apo dhe në rastet kur klienti, ka paraqitur dhe është në proces të trajtimit të kërkesës së tij, për t' u klasifikuar si “klient në nevojë”. Pra, ata janë vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, pikërisht për shkak të gjendjes së tyre sociale dhe të asaj ekonomike.

Konstatojmë se, ERE ka informuar Komisionerin lidhur me hapat e ndërmarra prej tyre në zgjidhje të kësaj problematike, si dhe ka vënë në dispozicion dokumentacionin lidhur me procedurën e ndjekur prej tyre për hartimin e draft rregullore “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”. Komisioneri vlerëson në tërësi parashikimet e kësaj draft rregulloreje dhe nxit miratimin e saj. Po ashtu, rekomandon Ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë, Ministrinë e Financave, dhe në konsultim me ERE-n e grupet e interesit, siç përcaktohet dhe në nenin 95 të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të marrë masa të menjëhershme për hartimin e kriterëve, procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 3, pika 1, nenin 7, pika 1, nenin 11, nenin 32, pika 1, germa a) dhe, nenin 33, pikat 9 dhe 10 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Përmbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të znj.D. D nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shkak të gjendjes sociale dhe gjendjes ekonomike, përmes mos nxjerrjes së aktit nënligjor, në të cilin parashikohen kriteret dhe procedurat e përfitimit të statusit të klientit në nevojë dhe mënyra e trajtimit të tyre.
2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartojë aktin nënligjor përkatës për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përfitimit të statusit të klientit në nevojë dhe

mënyrës së trajtimit të tyre, sipas përcaktimeve të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, të informojnë Komisionerin lidhur me masat e ndërmarra, për sa më sipër.
4. Në referim të nenit 33, pika 13, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: gjendja sociale, gjendja ekonomike)

(fusha: të mira dhe shërbime)